

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO		
KOMUNA E PODUJEVËS / OPŠTINA PODUJEVO / MUNICIPALITY OF PODUJEVA		
DREJTORIA E ADM. "GJISTRA" ÇS - UPRAVA ADMINISTRACIJE		
Dërguar më Dostavljeno		23.01.2025
Njësi.org. Org. jed.	Nr. Br.	Shtojcë - Prilog
15-500/01-0005083/25		
PODUJEVË - PODUJEVO		



KOMUNA E PODUJEVËS

Opština Podujevo

Municipality of Podujeva

DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT EKONOMIK

PLANI I PUNËS PËR VITIN 2025

HYRJE

Komuna e Podujevës, shtrihet në verilindje të Kosovës dhe ka sipërfaqe prej 633.86 km² (5.8% të sipërfaqes së Republikës së Kosovës). Në aspektin e pozitës gjeografike, Komuna e Podujevës shtrihet në luginën e lumit Llap. Ajo kufizohet me pesë komuna tjera të Republikës së Kosovës: Prishtinën, Obiliqin, Vushtrrinë, Mitrovicën dhe Leposaviqin. Në bazë të regjistrimit të popullsisë nga Enti i Statistikave në vitin 2024, Komuna e Podujevës ka 71.018 banorë. Përbëhet nga qyteti dhe 77 fshatra.

Sipas të dhënave nga Trusti Pensional i Kosovës kontributpagues nga komuna jonë janë afro 21.678 të punësuar por duke pas parasysh informalitetin e lartë që shkon deri në 20 % (mesatare në nivel Kosove) numri real i të punësuarve është më i lartë.

Nga raportet e Zyres për Regjistrimin e Bizneseve në Komunën e Podujevës pranë ARBK-së janë të regjistruara gjithsej 3651 biznese.


VIZIONI

Komunë e suksesshme me mundësi të barabarta për të gjitha gratë dhe burrat e saj.

MISIONI

Komuna e Podujevës përkushtohet në përmirsimin e jetës së grave dhe burrave në zhvillimin e qëndrueshëm, rritjen e mirqenjes sociale dhe ekonomike, ofrimin e arsimit cilësor, zhvillimin e turizmit, promovimin dhe përkrahjen e aktiviteteve kulturore dhe sportive, si dhe administratë efikase.

STRUKTURA E DREJTORISË



FUSHËVEPRIMTARIA E DREJTORISË

- *Koordinon, përgatitë dhe harton Strategjinë zhvillimore dhe plane e projekte të veçanta për krijimin e një kornize të përshtatshme për zhvillim të qëndrueshëm të Komunës.*
- *Në bashkëpunim me Kryetarin e Komunës, Ministritë, institucionet tjera relevante dhe grupet e veçanta të interesit, identifikon mundësitë zhvillimore dhe propozon programet prioritare si dhe masat për realizimin e tyre.*
- *Përcjellë ecuritë ekonomike sipas sektorëve në përgjithësi dhe zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në veçanti.*
- *Grumbullon dhe përpunon të dhëna statistikore për bizneset, resurset njerëzore dhe natyrore me rëndësi për hartimin e informacioneve, analizave planeve dhe programeve për zhvillim të Komunës.*
- *Përcjellë tregun e punës, identifikon nevojat dhe propozon masa për harmonizimin e ofertës dhe kërkesës në lëmi të caktuara.*

- *Bënë promovimin e resurseve zhvillimore të Komunës përmes buletineve, panairove dhe organizimeve tjera.*
- *Hulumton dhe identifikon projektet dhe koordinon punët rreth partneritetit publiko privat.*
- *Mban kontakte me donatorë, komunitetin e biznesit dhe bashkatdhetarët që jetojnë në botën e jashtme për krijimin e kushteve për investime në Komunë.*
- *Ofron këshilla, organizon programe trajnuese dhe rikualifikuese si dhe asistencë teknike për bizneset e reja.*
- *Bënë regjistrimin, ndryshimin e veprimtarisë dhe çregjistrimin e bizneseve dhe mban data bazë për numrin, strukturën dhe selinë e bizneseve.*
- *Zbaton politikat e përcaktuara dhe aktet normative nga fushëveprimtaria e Komunës në lëmin e zhvillimit dhe planifikimit.*
- *Harton propozime të akteve të përgjithshme normative nga fushëveprimtaria e Drejtorisë.*
- *Bashkëpunon dhe koordinon punët dhe aktivitetet me Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik.*
- *Kryen edhe punë tjera të caktuara nga Kuvendi dhe Kryetari i Komunës.*

OBJEKTIVAT DHE SYNIMET

- *Zhvillimi dhe përmisimi i vazhdueshëm i ambientit të të bërit biznes në komunën tonë.*
- *Ngritja e politikave dhe masave stimuluese për tërheqjen e investimeve.*
- *Fuqizimi i tregut të punës.*
- *Mbështetja e të rinjëve përmes start-up bizneseve, trajnimeve për përgatitje për tregun e punës.*
- *Qëndrueshmëria financiare e komunës.*
- *Ngritja e kapaciteteve në promovimin e komunës dhe tërheqja e investimeve të huaja.*
- *Fuqizimi i ekonomisë lokale përmes investimeve në kapitalin njerëzor.*
- *Shfrytëzimi i resurseve natyrore në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik.*
- *Përmirësimi i kushteve për zhvillimin e turizmit lokal.*
- *Përmirësimi i infrastrukturës publike në funksion të bizneseve dhe turizmit.*
- *Ngritja e partneritetit me komunitetin e biznesit dhe shoqërinë civile në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm.*
- *Ruajtja dhe vendosja e kontakteve të reja me donator vendor dhe të huaj.*

AKTIVITETET E PLANIFIKUARA

❖ Sektori për Planifikim dhe Zhvillim Ekonomik

- Zbatimi dhe monitorimi i "Rregullores për Orarin e Punës për Bizneset që operojnë në territorin e Komunës së Podujevë
- Zbatimi dhe monitorimi i "Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal 2023-2025
- Organizime të trajnimeve për të rinj në IT dhe Web-dizajn në bashkëpunim me organizata dhe institucione tjera.
- Trajnim për gratë në të bërit biznes dhe promovim të produkteve në bashkëpunim me organizata dhe institucione tjera.
- Përgjigje dhe ndihma e ofruar në logjistik si dhe mbarëvajtjen e punëve në thirrjet e organizatave dhe institucioneve për bashkëpunim në organizime me biznese dhe palë tjera të interesit.
- Pajisja me certifikata stazhi për kontributpaguesit për biznese të periudhës së paraluftës, arkivimi dhe regjistrimi i lëndëve në protokoll.
- Angazhim për themelimin e Inkubatorit të Biznesit.
- Anketë me komunitetin e bizneseve në lidhje me tregun e punës.
- Vendosja e të dhënave në Programin e Investimeve Publike PIP në kuadër të Ministrisë së Financave (periudha kohore 2024-2026 nr.i projekteve kapitale: 100)
- Raporti i progresit në realizimin e projekteve.
- Identifikimi i resurseve dhe produkteve turistike në bashkëpunim me shoqatat dhe grupet e interesit nga fusha e turizmit.
- Vendosja e kiosqeve (shtëpive të drurit) në mbështetje të bizneseve dhe të rinjëve me rastin e ditëve të diasporës dhe festave të fund vitit.
- Përditësimi I rexhistrir nga ARBK-ja duke selektuar bizneset e grave, sipas sektorëve dhe shtrirjes teritoriale dhe aktivitetit (aktive dhe pasive)..
- Promovimi i ofertës turistike.
- Zhvillimi i produkteve turistike.

- *Mbikqyrja e investimeve në produktet ekzistues turistike dhe mirëmbajtja e vazhdueshme e tyre.*
- *Pregaditja dhe zhvillimi I projekteve për aplikim në ministrit relevante dhe organizatat tjera vendore dhe të huaja..*
- *Kontrrolli I vazhdueshëm I projekteve dhe përfituesve në ndarjet dhe mbështetjet nga drejtoria e jonë.*
- *Organizimi i tryezave të perbashkëta me investitorë të brendshëm dhe të jashtëm si dhe me komunitetin e bizneseve.*
- *Sesionet informuese në lidhje me te gjitha thirrjet publike për realizimin e objektivave të drejtorisë.*

Investimet kapitale

- ✓ *Ndërtimi i infrastrukturës në zonën ekonomike.*
- ✓ *Ngritja e infrastrukturës për turizëm.*
- ✓ *Ndërtimi i tregut të ri të qytetit*
- ✓ *Ndërtimi i Parkingut nëntokësor me partneritet Publiko-Privat (projekt afatgjatë)*

Subvencione

- ✓ *Subvencionimi në paisjet /makinerit për bizneset prodhuese.*
- ✓ *Subvencionimi i start-up ve në paisje/makineri.*
- ✓ *Mbështetja e Ndermarjeve Publike Komunale*

❖ **Sektori për Regjistrimin e Bizneseve**

Fokusi ynë është krijimi i një imazhi ndihmës për procedurat administrative të regjistrimit në ndihmë të biznesit dhe përmirësimit të ambientit të biznesit në vend.

Qëllimi ynë është të ofrojm një shërbim institucional të përgjegjshëm dhe të krijojm një kulturë administrative tek biznesi.

Aktivitetet në kuadër të sektorit:

- *Regjistrimi i bizneseve të reja.*
- *Ndryshime në bizneset ekzistuese.*
- *Shuarje të bizneseve.*
- *Vërtetime individuale.*
- *Këshilla rreth procedurave dhe të të bërit biznes.*
- *Asistim për plotësimin e dokumentacionit.*
- *Rekrutimi i një zyrtari për regjistrim te bizneseve.*
- *Regjistrim i të gjitha bizneseve të reja, ndryshimeve dhe shuarjeve në databazë.*
- *Raportimi mujor në ministri i të gjitha pagesave të realizuara në kuadër të sistemit të Arbk-së.*
- *Arkivimi i lëndëve të zyrës së biznesit.*
- *Organizimi i sesioneve informuese për biznese.*
- *Asistimi në plotësimin e aplikacioneve në thirrjet publike nga organizatat dhe institucionet e ndryshme.*
- *Lëshimi i vërtetimeve për shtëpitë e djegura gjatë luftës së fundit.*
- *Si dhe punë dhe aktivitete tjera me kërkesë të drejtorit dhe kryetarit.*

BUXHETI PËR DPZHE – 2025

MALLRA DHE SHËRBIME –	Granti qeveritar	Të hyrat vetanake	Totali
	55,000		55,000
Shërbime kontraktuese	55,000		55,000
1.			
SUBVENCIONE			
		300,000	300,000
Subvencione për biznese dhe		300,000	300,000
1. Ndërmarrje Publike			

✓ Investime Kapitale 2025

Emërtimi i projekteve	Granti qeveritar	Te hyrat vetanake	Totali
Buxheti Total	500,000		500,000
Ndërtimi i Zonës	200,000		200,000
1. Industriale në Livadicë			
Ndërtimi i tregut të ri të	300,000		300,000
2. qytetit			

REFERENCA

- mbi të cilat është bazuar Plani i punës:

- *Strategjia për Zhvillim Ekonomik Lokal 2023-2025 e Komunës së Podujevës*
- *Plani Nacional për Zhvillim Ekonomik Lokal 2030*
- *Korniza afatmesme buxhetore*
- *Programi zgjedhor i Kryetarit të Komunës*
- *Ligji për vetëqeverisje lokale*
- *Statuti i Komunës së Podujevës*

Podujevë, Janar 2025

***Drejtor i Drejtorisë për Planifikim
dhe Zhvillim Ekonomik***

